

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 156, Datë 27-10-2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 29.09.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË


Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **29.09.2022**, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nen 53, pika 8 dhe nen 54, gërmë k) si dhe nen 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 29.09.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjeherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 29.09.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 28

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 28 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: zv Kryetari i Bashkisë z. Klejton Kita dhe drejtore të ekzekutivit.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me rendin e ditës nga ekzekutivi kishte 3 materiale që u sollën por ishin ditën e fundit jashtë afatit. Ju lutem mund ti cilësosh?

Zv. Kryetar i Bashkisë K.Kita : Propozojmë që të futen në rendin e ditës 3 materialet ardhur nga Drejtoria e Sstrehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale. Materiali i parë është për rishpërndarjen e banesave sociale me qira, materiali i dytë është për rishpërndarjen e banesave me kosto të ulët dhe materiali tjetër është relacioni për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha. Të kemi mirëkuptimin tuaj që meqënëse këto janë materiale të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me banorët e qytetit ti futim në rendin e ditës do ti shqyrtojmë për ti miratuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Paraprakisht bëhet fjalë për 1,2 nuk janë shpërndarë.

Ekzekutivi M.Balli: Tani do ti shpërndajmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë në lidhje me rendin e ditës ka diçka tjetër për të shtuar? Në cilën pikë mendoni për të futur këto materiale?

Këshilltare A. Verushi: Them se përderisa materialet nuk janë parë të vendosen në fund.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Para informacionit raporti i monitorimit janar-gusht 2022. Pra pika 13, 14, 15.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 29 Korrik 2022.(me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka nga këshilltarët diçka? Nga sekretari i këshillit ka diçka? U pa ka ndonjë problem?

Sekretare E.Naçi: Po u pa, nuk ka asnje problem.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 GUSHT 2022.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Gerla Koleci.

Këshilltare G.Koleci: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për muajin Gusht , janë 50 familje përfituese përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vëtmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kritereve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Përfitojnë 50 familje, të përzgjedhura sipas kritereve specifike të miratuara, në shumën 127.776 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 24 familje, në shumën 30.264 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 158.040 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kritereve specifike të miratuara 13 familje, me fond prej 32.054 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët e tjerë ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN E TITULLIT " QYTETAR NDERI" Z.KRISTO FLOQL. (PAS VDEKJES)

(Komisioni i Titujeve të Nderit) z.Pandi Bello, znj.Anna Verushi, znj.Edlira Menkshi, znj.Irena Nikaj, z.Xhino Isak.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni u mblodh.

Këshilltar P.Bello: Nuk ka nevojë për diskutim, rëndësinë e kësaj fìgure për qytetin e Korçës dhe mirënjojen që duhet ti shprehin duke i akorduar titullin "Qytetar Nderi" për veprimtarinë e tij shumë të rëndësishme. Do të mjaftonte vetëm periudha mbas vitit 1920 për krijimtarin e tij letrare, mbi 22 vepra gramatike. Duhet marrë parasysh se kush ishte situata dhe roli i madh që kanë luajtur veprat e tillë në vënien në skenë në Korçë por dhe në fshatrat e Korçës gjë që nuk ndodh fare tani, edhe në qytezat në Kamenincë etj. E ka merituar diçka të tillë, ka qënë iniciator i madhë i emacipimit të shoqërisë shqiptare që në vitin 1912 atëhere kur ekzistonte shpallja e pavarsisë nuk ekzistonin institucionet dhe konceptet mbi shtetin dhe ai bëri propagandë të madhe përmes publicistikës së tij për të krijuar këto koncepte në mendjen e njerëzve. Kultura e tij artistike dhe ndikimet e tij me artikuj publicitike jo vetëm në Korçë, por edhe në Vlorë, Shkodër, Tirana ku ai ka punuar është po ashtu i rëndësishëm gjurmët përfshirë efektin e madh që ka patur për shoqërinë shqiptare.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Relacion u bë nga komisioni këshillimor?

Sekretare E.Naçi: Relacioni përgatitet nga drejtoria përkatëse e artit dhe kulturës. Komisioni Këshillimor në fakt u mblodh po për rastin e Kristos ishin 2 anëtarë z.Pandi Bello dhe znj.Irena Nikaj. Jonela Spaho e dha konfirmimin e saj nëpërmjet telefonit por nuk mund të ishte sepse kishte temat e diplomës në universitet, profesore Ana nuk ishte atë ditë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po dakordësia është dhënë për këto. Atëhere komisioni si propozon, ta kalojmë në votim?

Këshilltar P.Bello: Po.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltare A.Verushi: Më fal një korrigjim këtu personalitet letrar artistik, aktivist i kulturës rilindjes dhe i emacipimit të shoqërisë shqiptare që në vitin që në vitin 1912. Tani është

domosdoshmërisht se për një periudhë të caktuar kohe flitet që u burgos etj me rradhë, në relacion dhe mos duhet ndonjë sqarim tjetër për një periudhë të caktuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë nuk kam asnjë propozim, ti je dhe pjesë e dy komisioneve. Kishit mundësi dhe konsultoheshit se kjo nuk mund të jetë pjesë e mbledhjes , zgjidheni bashkë këtë.

Këshilltar P.Bello: Në motivim nuk mund të shkruhet e gjithë biografia e personit. Shikohet efekti i madh që ka luajtur veprimtaria e tij.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem nuk po diskutojmë meritat profesor, po diskutojmë formulimin atje.

Këshilltar P.Bello: Kryetar formulimi bëhet në mënyrë sintetike ose sikretike që në vitin 1912 sepse bashkë me korçarë të tjerë kanë ikur nga Korça , kanë shkuar në Vlorë dhe kanë kontribuar kanë ndërtuar institucioni. Kristo Floqi është organizatori i mbledhjes së të gjithë shoqatave të shqiptarëvë në Amerikë në momentin e themelimit të federatës Vatra e cila udhëhiqej nga Noli dhe nga Konica, por iniciativa ka qënë e Kristo Floqit. Ka shumë merita.

Këshilltare A.Verushi: Nuk po flasim për meritat profesor .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të lutem e mbyllim debatin, materiali u votua. Këto diskutimet i bënit në komision po qe se kishit. Po qe se duhet të bëhen modifikime silleni prapë herës tjetër.

Pika 5 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETARE NDERI" ZNJ. ZHULJANA JORGANXHI. (me e-mail)

(Komisioni i Titujve të Nderit) z.Pandi Bello.

Këshilltar P.Bello: Kontributi i Zhuljana Jorganxhiut , ka lindur në Korçë me familje Korçare me tradita model për të gjithë shoqërinë shqiptare. Me një kontribut të madh jo vetëm si poete, por si njeri i kulturës, si njeri me profil artistik që nëse mund ta shikoni në shumicën e këngëve traditës muzikore shqipatara që kanë kaluar në festivalin e këngës në radio televizionin dhe radio Tirana të cilat një kohë zhvilloheshin në çdo muaj dhe kuptioni rëndësinë e kontributit të saj si njeriu që i duhet të kalonte të gjithë këtë illoj krijimtarie përvçe krijimtarisë se saj. Nuk ka qënë vetëm poete, ka qënë njeri i kulturës dhe e ka merituar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni përkatës u mblohd?

Sekretare E.Naçi: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mbajtët një relacion?

Sekretare E.Naçi: Po kemi dhe listprezencat dhe një procesverbal të shkurtër.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë propozimi mbasi ka kaluar rregulloren të mbështetur në ligj i propozoj këshillit bashkiak dhënien e titullit "Qytetar Nderi" z.Zhuljana Jorganxhi. Përpara se të votohet ka ndonjë-gjë tjetër me motivacionin?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" AT GARY WALSH.

(Komisioni i Titujve të Nderit) z.Pandi Bello, znj.Ana Verushi, znj.Edlira Menkshi, znj.Irena Nikaj, z.Xhino Isak.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ardhur një kërkësë unë ju kam informuar përpara disa muajve , për të vlerësuar një figurë të besimit katolik që ka kontribuar në fillim të viteve 90, jo vetëm në aspektin e ngritjes së institucioneve fetare por dhe në atë që do të zhvillojmë. Kontribut për të përmirësuar cilësinë e jetesës në qytetin e Korçës dhe në zonën e Korçës. Një kontributor si At Gary Walsh që e kemi diskutuar dhe herë të tjera , 2 mbledhje më përpara ose 3 mbledhje. Pritëm që të kishim dhe propozime nga njerëzit që e kanë njojur nga pranë. Në këtë mbledhje kemi paraqitur propozimin për ngritjet e komitetit këshillimor i cili do të shqyrtojë këtë propozim.

Këshilltar P.Bello: Kam unë një propozim për anëtar të komitetit këshillimor. Emri është ndoshta i njojur për një pjesë Anesti Treska. Është një nga profesorët e shkollës të Maltës i cili ka mbajtur peshën e madhe në 97 atëhere kur edhe petagogët e Maltës janë larguar dhe ai ka myllur vitin mësimor deri në fund. Është ende dhe në këtë moment, dhe e propozoj.

Këshilltare A.Verushi: Duke ju bashkëngjitur Pandit në llogjikën e argumentit përfaqësuesit që mbështetin këtë komitet. Personalisht do të doja që të ishte një nga drejtuesit e shkollës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo meqënëse në atë shkollë u propozua Anesti Treska të kemi dhe një shtesë.

Këshilltare A.Verushi: Do të propozoja dhe për drejtuesen e institucionit Mary Potter të jetë pjesë e këtij komiteti. Nuk e di nëse kemi akses.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi akses. Mundet që të përfshihet. Si e ka emrin?

Këshilltare A.Verushi: Irena Laska.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shumë mirë, ka ndonjë propozim tjetër?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës dhe pika 8 e rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Janë dy materiale që do të trajtohen së bashku sepse kanë lidhje me njëra tjetrën. Pika 7 është "PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË TRASHËGUAR NGA TRANSFERTA SPECIFIKE E VITIT 2021 NË BUXHETIN E VITIT 2022" dhe pika 8 është "PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 79 DATË 23.5.2022 "PËR DETAJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MBROJTJEN CIVILE".

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) znj. Mamica Nene.

Këshilltare M.Nene: Komisioni nuk u mblodh.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për parantezë kjo në lidhje me materialet, e shikoj që ka një pjesëmarrje tjetër krahasuar me mbledhjen e kaluar, kuptohet që pas pushimeve shtatori i ka gjetur me të angazhuar njerëzit. Shpresoj që në këto pak mbledhje që kanë mbetur brënda mandatit të jeni prezent. Tani dhe ato komisionet unë e kuptoj që është pak e vështirë që të funksionojnë por duam një përpjekje minimale të bëhet mbledhja me ata këshilltarët 2-3 që janë më aktivë. I jap fjalën përfaqësueses të ekzekutivit znj. Valbona Ziko.

Ekzekutivi V.Ziko: Atëherë materiali i parë PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË TRASHËGUAR NGA TRANSFERTA SPECIFIKE E VITIT 2021 NË BUXHETIN E VITIT 2022 ka të bëjë me vlerën 3,305,300 lekë e cila është miratuar me vendim të këshillit bashkiak nr. 21 datë 10.2.2022 e cila do të përdorej për blerje automjeti. Për shkak të mos realizimit të procedurave, për shkak të ndryshimit të çmimeve dhe të vështirësive të hasura gjatë procedurave të propozuara është menduar që ky fond meqënëse është fond që trashëgohet në vitin 2022 do të përdoret sipas kritereve të vendimit të këshillit të ministrave nr. 414 datë 8.7.2021 shpenzime për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore. Kemi thjesht një ndryshim të destinacionit të shpenzimit por jo të fondit i cili është miratuar me VKB. Këtë kërkojmë në ky material. Po për përballimin e fatkeqësive dhe duke qënë se është fond që trashëgohet, ndërsa në ndryshim nga viti 2021 fondi i cili përdoret për imbrojtjen civile ka ardhur në formën e transfertës të kushtëzuar që do të thotë që ky fond nuk trashëgohet për vitin pasardhës, pra në vitin 2023. Me VKB nr. 79 është miratuar përdorimi i kësaj transfertës të kushtëzuar më vlerën 26,661,278 lekë. Për shkak të disa fonde nuk arriten që të zhvilloheshin procedura të prokurimit, ndërsa tek disa të tjera janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe fondet e mbetur janë menduar që të rialokohen përsëri sepse është këshilli

bashkiak ai që vendos për përdorimin e këtyre fondeve. Pra në tabelë duke qënë se fondi 3,305,300 lekë u kalua për përballimin e dëmeve në raste zjarri, fondi i miratuar 4,621,278 lekë do të hiqet nga kjo shpenzimet për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore. Shpenzimet për blerjen e pajisjeve profesionale në vlerën 8,540,000 lekë janë zhvilluar procedurat e prokurimit eshtë lidhur kontrata me vlerën 7,424,520 lekë dhe fondi i mbetur do të kalojë përsëri për rialokim të shpenzimeve që do i trajtoj më poshtë. Rehabilitim në objektet infrastrukturore, dhe për këtë eshtë zhvilluar procedura e prokurimit do të zhvillohet përsëri sepse ka dështuar procedura e prokurimit të tenderit. Shpenzime për blerje karburanti 5,000,000 lekë eshtë zhvilluar procedura dhe eshtë lidhur kontrata. Shpenzime për prishjen e objekteve infrastrukturore që përbëjnë rrezik për jetën e njerëzve 1,500,000 do të pakësohet nga ky zë dhe fondet që do të shtojmë janë 2,861,758 për blerje karburanti gjithmonë në raste emergjente. Shpenzime për blerje kripe janë planifikuar në vlerën 3,000,000 lekë do të iritet për shkak se kanë ndryshuar çmimet dhe në llogaritjet që janë bërë nga ekzekutivi duhet të shtohen dhe 1,375,000 lekë dhe 3,000,000 lekë do të përdoren për ndërtimin e pritave malore në fshatin Neviçisht. Pra totali i fondit që shtohet eshtë 7,236,758 lekë dhe po aq do të pakësohet. Kërkoi miratimin sipas tabelës që eshtë paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka për të shtuar? Sa % eshtë kjo rritja?

Ekzekutivi V.Ziko: Jo nuk ka rritje, eshtë lëvizje brenda për brenda fondit, nuk eshtë rritje. Llogaritja vjen nga komisioni që eshtë për procedurën e prokurimit dhe unë nuk e kam shumë të qartë sa eshtë vlera që eshtë rritur.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ku ndryshon atëhere nga sa ishte në ku vajti?

Ekzekutivi V.Ziko: E pra 3,000,000 lekë, ka qënë qënë e planifikuar i bie 45%. U zhvillua procedura e prokurimit dhe nuk u realizua për shkak të çmimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Se di sa % zë dhe transporti.

Ekzekutivi V.Ziko: Është përfshirë dhe transporti.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Hidhet në votim pika 7 e rendit të ditës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim pika 8 e rendit të ditës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 146 DATË 22.12.2021 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022.”

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiakë, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Valbona Ziko.

Ekzekutivi V.Ziko: Sipas VKM nr. 604 datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” është përcaktuar se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi është 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë. Për këtë arsyе kërkohet që për Bashkinë Korçë dhe Ndërmarrjet në varësi për klasën I të ndryshohet kategoria fiksë nga 32 000 lekë në 34 000 lekë, për klasën II të ndryshohet kategoria fiksë nga 32 700 lekë në 34 000 lekë dhe për klasën III të ndryshohet kategoria fiksë nga 33 400 lekë në 34 000 lekë. Efektet financiare të rritjes së pagës minimale do të përballohen nga buxheti i viti 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit.

Ekzekutivi V.Ziko: Mbledhjen tjetër do ta ndryshojmë sepse do të ketë përsëri ndryshim të pagave me vendimin e ri që morri qeveria.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË BUXHETIT DHE PËRDORIMIN E FONDIT PËR RRITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONIN E ARSIMIT PARASHKOLLOR NË NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHES.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiakë, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi nga arsimi dhe çerdhja? Përsëri Valbona Ziko.

Ekzekutivi V.Ziko: Me VKM janë miratuar disa ndryshime për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve jo mësimorë në arsimin parauniversitar ku përfshihen edukatoret dhe kuzhinieret. Vendimi është zbatuar sepse ka hyrë në fuqi që në korrik, domethënë jo se do hyjë tani në fuqi vendimi por foni nga i cili do të përballohet është miratuar nga Ministria e Financave në muajin shtator dhe kërkohet nga Këshilli Bashkiak sepse kjo vjen në formën e transfertës së pa kushtëzuar sektoriale , dhe kërkohet të miratohet nga Këshilli Bashkiak e detajuar për shpenzime për paga me vlerën 2,840,000 lekë dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore 480,272 lekë i cili i shtohet buxhetit të ndërmarrjes së shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdhes.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023 – 2025, FAZA E DYTË.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) znj. Valbona Ziko.

Ekzekutivi V.Ziko: Hartimi i buxhetit për programin buxhetor afatmesëm 2023-2025. Duke ju referuar dhe udhëzimit nr 25 të muajit korrik për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm Detajimi i buxhetit, do të jetë në të njëjtat nivele sipas tavaneve të miratuara sipas VKB nr. 121 datë 29.7.2022. Burimet financiare në fazën e dytë nuk kanë pësuar ndryshime nga faza e parë. Në vitin 2023 buxheti ishte 1,919,861 lekë, në vitin 2024 1,962,869 lekë, dhe në vitin 2025 2,008,461 lekë. Burimet financiare nuk kanë ndryshuar. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë përsëri ato që janë planifikuar në fazën e parë. Rritja nga viti në vit është 1% ashtu sikur ishte dhe në fazën e parë. Transferta e pakushtëzuar është përsëri në ato nivele që u miratua në fazën e parë, pra në vitin 2023 ka një rritje prej 6.8% në krahasim me vitin 2022, në vitin 2024 ka një rritje prej 6.5% krahasuar me vitin 2023 dhe në vitin 2025 ka një rritje prej 6.6% krahasuar me vitin 2024. Transferta e pakushtëzuar sektoriale do të jetë në të njëjtin nivel me vitin 2022 pra nuk do të kemi ndryshime për 3 vite. I vetmi ndryshim që është bërë në fazën e dytë dhe sipas rekomandimeve të Ministrisë së Financave në qoftë se në fazën e parë buxheti ishte planifikuar për 7 programe tani buxheti do të planifikohet në 9 programe të cilat po i citoj :

planifikimi i menaxhimit dhe administrimi, siguria publike, mbrojtja e mjedisit, shërbimet publike vendore, shërbimet e kujdesit parësor, kultura sporti dhe argëtimi, arsimi bazë përfshirë dhe arsimin parashkollar, arsimi i mesém i përgjithshëm dhe kujdesi social. Pra ndryshimi i vetëm është ndryshimi i programeve dhe janë bërë lëvizjet përkatëse. Mund të citoj dhe lëvizjet që janë bërë programi planifikimi i menaxhimit dhe administrimi në fazën e parë është planifikuar për qëndra sportive dhe kontributin e Bashkisë për ekipet e futbollit, u hoq nga programi planifikim i menaxhimit dhe administrimi dhe u kalua në programin e sportit dhe argëtimit. Investimet të cilat ishin planifikuar në infrastrukturën rrugore pra në këtë program u kaluan programin e shërbimeve publike vendore. Investimet e planifikuara në arsim u kaluan në programin e arsimit të mesém të përgjithshëm. Në të njëjtën kohë të gjitha projektet që ishin planifikuar për mjedisin u kaluan në programin mbrojtja e mjedisit. Në programin e shërbimeve publike vendore ishte planifikuar buxheti për shërbim dhe pastrim dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, të gjitha këto u kaluan në programin mbrojtja e mjedisit. Në programin e arsimit u hoqën shpenzimet e planifikuara për arsimin e mesém dhe arsimin profesional dhe u kaluan në arsimin e mesém të përgjithshëm. Pra këto ndryshime janë bërë, ndërsa shifra totale nuk ndryshon.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët? Nuk e di nëse ndonjëri mund të na japë ndonë ide në lidhje me ngrohjen. E cilësova që mund të mos jetë lidhja direkte me programet që apo lexi Valbona, se ky është një kombinim midis asaj që ne konsiderojmë çështje të rëndësishme për mjedisin, investime nën mjedis etj por është edhe në të njëjtën kohë çështje për të zgjidhur probleme të shumta sociale sidomos këtë vit që janë krijuar nga shtrenjtimi i lëndëve djegse për ngrohjen me mënyra tradicionale.

Ekzekutivi V.Ziko: Kjo që kemi miratuar ne është faza e dytë e buxhetit, ka dhe një fazë tjetër e cila do të jetë faza përfundimtare që përfshin hartimin e buxhetit të 2023 dhe ne dje kemi nxjerrë urdhërin e titullarit të bashkisë që e kemi bërë më shpejt se vitet e tjera për hartimin e buxhetit 2023 i cili është viti i parë i buxhetit afatmesëm për vitin 2023-2025. Dhe besoj se do të diskutohet edhe kjo sepse është vërtet një problem.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Okay atëherë, po qe se ka mundësi të mbahet shënim edhe si çështje që në mbledhjen tjetër përvëç asaj që ju do keni në vëmendjen tuaj për buxhetin 2023 prapë është ky diskutim sepse gjatë këtij muaji më ka ndodhur disa herë që qytetarët të njojur apo të thjeshtë më pyesin si do të jetë zgjidhja imediate mbështetëse s'ka, po si do jetë zgjidhja afatmesme për ngrohjen sidomos në qytetin e Korçës, edhe në fshat. Po flasim për fshatrat që janë në fushë siç mund të jetë Qatromi, Drenova edhe Barçi edhe Bulgareci, pra të gjithë fshatrat që nuk kanë akses direkt.

Zv. Kryetar i Bashkisë K.Kita: Shqetësimi që u ngrit në Këshilli Bashkiak është një shqetësim që ne e kemi marrë seriozisht si bashki dhe po shohim të gjitha mundësitet për tu ardhur në ndihmë banorëve për pjesën e ngrohjes dhe është një projekt shumë i madh dhe nuk bëhet sot për nesër por që duhet ta mendojmë në një plan afatmesëm, ndërkohë që për plane afatshkurtra ne kemi nisur disa projekte bashkë me Fondin Shqiptar të Zvillimit ku po bëjmë termoizolimet e disa pallateve në qytetin e Korçës, 4 pallate tek rruga e drithave të verdha, do nisen të bëhen dy pallate

tek pallati përballë kinemasë dhe pallati i ish Agimit, dhe gjithashtu tek zona e ish baçes të ushtrisë në rruga 10 korriku kemi mbaruar pjesën e termoizolimit. Kjo përfshin termoizolimin e të gjithë pallatit, ndërimin e dyerive dhe dritareve të apartamenteve dhe izolimin e tarracave. Këto janë projekte afatshkurtra por që ndihmojnë në pjesën e eficencës së energjisë, ndërkohë që për pjesën e ngrohjes bashkë me kryetarin jemi duke parë mundësi për pjesën e furnizimit me druri por është shumë e vështirë në këto kushte. Nuk është se varet vetëm nga bashkia por do dhe ndihmë nga pushteti qëndror.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës

“PËR DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT NR.25 DATË 27.02.2020 TË KËSHILLIT TË BASHKISË PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE.”

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo.

Këshilltar Gj.Kristo: Iniciuar nga një direktivë e Agjensisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkia Korçë ka nisur dialogun me disa institucione vendore me qëllim krijimin e KVSP-ve. Konkretnisht me vendimin nr.25 datë 27.02.2020 Këshilli Bashkiak Korçë miratoi krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) për Bashkinë Korçë. Me shkresë protokolluar pranë Bashkisë Korçë me nr.688/6 Prot. Myftinia Korçë, si përfaqësues i komunitetit mysliman Korçë, konfirmon pjesëmarrjen e tij në Këshilli Vendor i Sigurisë Publike Korçë, duke emëruar përfaqësuesin e tij në KVSP. Me vendimi nr.57 datë 28.05.2020 i Këshillit Bashkiak Korçë nëpërmjet të cilit u shtua institucioni i Myftinisë Korçë si anëtar i Këshillit të Sigurisë Publike Korçë. Propozimi vjen konkretnisht vendimi nr.25 datë 27.02.2020 ndryshimin e pikës 1 si në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra e thënë shkurt Këshilli i parë ka qënë me përfaqësues me emra dhe sot është me pozicione.

Këshilltare A. Verushi: Titullari i institucionit t'ia delegojë përfaqësuesit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në fakt mund t'ju informoj u bë dhe një trajnim para 2 javëve mos gaboj, unë isha prezent por nga ekzekutivi nuk kishte nivel përfaqësimi dhe pata përshtypjen që nga ajo që u diskutua atje pika kryesore ose organi kryesor që do merret me organizimin e Këshillit vendor të sigurisë publike është kryetari i bashkisë. Besoj që materialet do të jenë

evidentuar, do ti kenë në konsideratë qoftë për një rregullore që duhet, qoftë për një kordinator që duhet por ne sot po miratojmë thjesht si do jetë përbërja e këtij këshilli. Ka ndonjë diskutim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 13 e rendit të ditës

PËR RISHPËRNDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: I lutem drejtoreshës shkurt për çdo material.

Ekzekutivi M.Balli: Materiali i parë ka të bëjë me rishpërndarjen e banesave sociale me qira.Banesat sociale me qira janë banesa që janë në pronësi të Bashkisë Korçë. Ky fond në fakt është një fond qarkullues. Në momentin që lironen këto apartamente kalojnë tek familjet e tjera. Këto familjet e tjera janë familje që kanë në problematikën e tyre ndryshim të kushteve sociale dhe ekonomike, kryesisht persona me aftesi të kufizuar që paaftësinë e kanë marrë gjatë banimit në ato apartamente, me kujdestari ose kanë edhe ndryshim të nivelit ekonomik. Ne sot sjellim për rishpërndarje 4 apartamente. Këto apartamente janë liruar për shkak se familjet që kishim strehuar atje përfituan nga programe të tjera strehimi siç janë banesat me kosto të ulët apo kredia e butë dhe dikush tjetër për shkak të ndryshimit të statusit ekonomik u shkëput nga strehimi social dhe e morri strehimin në treg të lirë. Familjet që janë përzgjedhur për të përfituar nga kjo rishpërndarje janë në prioritetet e kategorisë që përfitojnë këtë lloj strehimi me persona me aftesi të kufizuar dy familje që marrin kontigjentin 1+1 dhe dy familjet e tjera janë gra kryefamiljare të divorcuara dhe me persona me aftesi të kufizuar në familjet e tyre. Ne këtë material e diskutuam dhe me komisionin e strehimit dhe me miratimin e komisionit të strehimit i propozojmë Këshillit Bashkiak të bëjë autorizimin e kësaj rishpërndarje për banesat sociale me qira.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje? Pra të treja materialet.

Ekzekutivi M.Balli: Të kaloj tek materiali tjetër ?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po.

Ekzekutivi M.Balli: Materiali tjetër ka të bëjë me banesat me kosto të ulët. Banesat me kosto të ulët janë fond i entit kombëtar të banesave. Prej gati më shumë se një periudhe 12 mujore nga enti kombëtar i banesave jemi vënë në dijeni që ka një apartament të lirë. Mbasi zyra e strehimit bëri njoftimin publik në një farë mënyre pati familje të interesuara për të përfituar nga ky strehim, por në momentin që atyre ju komunikoheshe pozicioni tërhiqeshin , sepse pozicioni është në katin e 8 tek banesat që ndodhen në rruga e Kolonjës ku janë të ndërtuara pothuajse të gjitha banesat e entit kombëtar dhe në listimin që bëri zyra mbeti vetëm një familje, familja e z. Olgert Robert Demo i cili plotësonë të gjitha kriteret sipas sistemit të pikëzimit ku në rastin e banesave me kosto të ulët kusht themelor përvèc pjesës së statusit të strehimit janë të ardhurat

dhe ai e plotësonte nivelin e të ardhurave kështu që mbeti i vetmi kandidat në listë. Edhe për këtë rast u diskutua me komisionin e strehimit dhe më pas pasi u miratua nga komisioni ne preqatitëm këtë materialin për ta autorizuar Këshilli Bashkiak. Kemi dhe instrumentin tjetër financiar që është subvencion i qirasë për familjet pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulta. Pranë zyrës së strehimit përgjatë gjithë kohës bëhen aplikime dhe për këtë instrument financiar që është pjesë e programit të banesave sociale me qira ka aplikime pothuajse në çdo kohë dhe pa kufizime kështu që ne na kanë ardhur aplikime nga dy familje të cilat dhe ato janë gra kryefamiljare të divorcuara me probleme të dhunës në familje. Mbasi u shqyrtua nga zyra pjesa e dokumentacionit e cila ishte e plotë u listuan familjet, ia kaluam komisionit të strehimit u bë miratimi dhe pastaj e sollëm këtu në Këshilli Bashkiak për të autorizuar subevpcionin e qirasë. Këto familje janë fare pa të ardhura dhe do të financohet komplet qiraja, por qiraja në këtë rast është me bashkëfinancim me buxhetin e shtetit, sepse ne kemi fond për vitin 2022 kemi fond të lirë. Këto janë 3 materialet që ne sollëm në Këshillin Bashkiak për të autorizuar për strehim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përpara se të kalojmë në votim kam një pyetje Mirela, në lidhje me ato kreditë e buta ky vit si e ka pasur ecurinë, ka kërkesë apo jo?

Sekretare E.Naçi: Ka pasur qytetarë të interesuar.

Ekzekutivi M.Balli: Aplikime filluan që në ditët e para të vitit 2022, u angazhuan rajonet me mbledhjen e aplikimeve por në muajin prill të këtij viti doli një vendim i Këshillit të Ministrave i cili për këtë instrument financiar kërkonte aplikim online dhe aplikim për këtë instrument për kredinë e butë duhet të jetë online. Ne ja u kemi komunikuar qytetarëve kemi dalë dhe në media kemi bërë dhe njoftim në faqen e bashkisë, kështu që të gjithë ata që kanë bërë aplikimet në dokumenta fizike normalisht duhet të bëjnë dhe aplikimin online. Çdo ditë në zyrë na vijnë qytetarë të interesuar për aplikime të reja por dhe ata që kanë bërë aplikimet dhe ne i kemi në dosje. Mendoj që duke ju lënë dhe pak kohë për pjesëne aplikimit online në të paraqesim pranë Këshillit Bashkiak një listë të madhe ashtu siç na kanë ardhur aplikimet dhe me plotësim të kërkesave kupotohet. Gjithashtu na kanë ardhur dhe kuota të tjera shtesë nga ministria. Na janë shtuar dhe 21 kuota për kredinë e butë dhe kemi menduar që të mos fusim lista herë pas here siç ka ndodhur më parë njëherë 10, njëherë 15, 20 por të kemi një listë të madhe të cilën ta depozitojmë tek banka dhe banka pastaj të vazhdojë procedurat. Gjithmonë për ata që plotësojnë kriteret për të përfituar nga ky instrument financiar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë pavarsisht praktikave si ndryshojnë online apo, unë do sugjeroja që të mos presim listën e madhe sepse këto kanë dhe një përcaktim afati vjetor dhe ne po qe se ja u miratojmë në nëntor zere se s'ja u kemi miratuar, se banka për sa kohë do i procesojë etj. Duhet të bëhet një listë me 10 këtu ne nuk besdisemi, madje për këtë çështje unë duke ju referuar dhe këshilltarëve të tjerë jam i gatshëm të bëjmë një mbledhje të postashme , t'ju lehtësojmë jetën njerëzve. Nuk është problem të garantoj që ne të mblidhem dhe për një person. Po qe se ne i ndihmojmë, ua lehtësojmë jetën këtu i nxitim që të qëndrojnë në këtë qytet, dhe për një familje mos presim listën e madhe se cila bankë do të proçesojë 80 aplikime njëherësh. Nuk

ka strukturë bankare këtu që të procesojë 80 aplikime njëherësh, se atje kalojnë pastaj sipas filtrave të kredisë normale, kështu që nuk duhet të presim, po qe se e keni evidentuar unë ju sugjeroj që bëjeni praktikë edhe sikur 5 të kenë kërkesë ata 5 duhet të vijnë këtu.

Ekzekutivi M.Balli: Dakord do ta konsiderojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po pritëm listën e madhe nuk kë çe do, nuk kompletohet asnjëherë, nuk do të kenë mundësi ata. E para bankat janë të përcaktuara, janë ato banka të cilat kanë marrëveshje me Ministrinë e Financave. Sa banka janë?

Ekzekutivi M.Balli: Janë 2 banka.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: 2 banka shumë mirë, po qe se janë 50 aplikime jo 80, asnjë bankë nuk i menaxhon dot nga ato të dyja sikur të angazhojë të gjithë fokusin për këtë çështje kështu që ju lutem mos prisni që të mblidhen pa të vijnë këtu. Ato formularë i kini, materiali është dhe thjesht verifikimi që bëni ju në bazë të kritereve që janë 2-3 kritere sa janë për të përfituar pikët, mosha të ardhurat etj që ju i keni shumë të thjeshta besoj.

Ekzekutivi M.Balli: Ne patjetër që do ta konsiderojmë këtë sugjerim tuajin dhe unë e shikoj të rëndësishëm sepse i hapim një rrugë strehim për shumë familje por problemi ka qënë tek aplikimi online për këtë instrument.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Le ti asistojnë në rajonet .

Ekzekutivi M.Balli: Jo aplikimin duhet ta bëjnë nga llogaritë e tyre.

Këshilltare E.Tare: Kjo është një problematikë e madhe që ndodh me aplikimin online jo vetëm për këtë rast por edhe për shumë raste të tjera.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë le të zgjidhet kjo. Nuk e zgjidh dot drejtoria le ta zgjidhë rajoni.

Ekzekutivi M.Balli: Jo mua në këtë kategori nuk më duket se është problem sepse ato janë familje të reja kanë një nivel arsimor, kulturor dhe nuk më vijnë pengesa në lidhje me aplikimin tek subvencion i interesave të kredisë, kurse për këto programet e tjera po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Je në gjëndje të na thuash sa është deri sot aplikimi ?

Ekzekutivi M.Balli: Po janë rreth 40 aplikime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po duhen urgjen atëhëre, unë jam gati që javën tjetër të bëj mbledhje vetëm për këtë çështje.

Ekzekutivi M.Balli: Po ja ti shikojmë. Disave ju kemi lënë kohë për plotësimin e dokumentave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ato që kanë plotësuar dokumentat të vazhdojnë procedurën se do jetë e pa menaxhueshme nga bankat pastaj, plus që po ndryshon dhe shumë tregu i banesave po ndryshon tregu i kredive dhe nuk mund ti lemë të bëhet më keq.

Ekzekutivi M.Balli: Jo ne do avancojmë patjetër. Në mbledhjen e rradhës do sjellim një material.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po qe se ju keni 10 emra 15, 20, 5 , nuk ka kundërshtime besoj nga asnjë këshilltar këtu që ne të mblidhemi për këtë çështje. Fillojmë procedurën e votimit për pikën 13 të rendit të ditës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e 14 e rendit të ditës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e 15 e rendit të ditës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në vijim ka kërkuar fjalën në emër të aleancës së këshilltarëve znj. Danjela Nasto.

Këshilltare D. Nasto: Të nderuar këshilltarë dhe qytetarë që na ndiqni si nënkyetare e Aleancës së Këshilltarëve Bashkiake e në përfaqësim të saj ju informojmë për punën e bërë nga aleanca, për nismat e marra dhe arritet. Fillimi është një falenderim shkon për projektin e qeverisë Zviceriane "Bashki të Forta" për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë. Siç e dini misioni i aleancës së këshilltarëve bashkiake eshtë që të bashkojë gratë dhe burrat anëtarë të këshillave bashkiakë në shqipëri, të punojnë për të zhvilluar dhe advokuar për legjislacionin politikën dhe nismat e tjera që ju përgjigjen çështjeve që prekin nevojat e grave dhe komuniteteve, rritjen e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Aleanca e këshilltarëve të bashkisë Korçë ka mbështetur dhe ka ndërmarrë nismën dhe shtron për zgjidhje çështjet si më poshtë :

1- Lehtësimi dhe ndihmë financiare për gratë që zhvillojnë biznes në fushën e artizanatit përmes krijimit të fondit përfshirë ekonomik të grave nëpërmjet mbështetjes së sipërmarrjes së vogël.

2- Miratimi dhe monitorimi i rezolutës kundër dhunës ndaj grave dhe mbështetje për viktimat e dhunës gjinore, lobim për rritjen e mbështetjes financiare përfshirë femrën dhe viktimat e dhunës.

3- Çmimi "Gruaja e Vtitit" në fusha të ndryshme të veprimtarisë sociale, politike, administrative, edukitive dhe biznesit.

4- Fushatë sensibilizuese për 8-Marsin ditën e gruas.

5- Mbështetje dhe ndihmë nga Aleanca dhe komisioni i Mirëqënieve sociale, strehimit, rinisë, barazisë gjinore, mosdiskriminimit, të drejtave të njeriut përfshirë familjet në nevojë me rastin e festave të fundvitit.

6- Fushata Këpucët e Kuqe , fushatë kombëtare kundër dhunës ndaj grave që u realizua edhe në Korçë në mjeshterë universitetit Fan Noli.

Gjithashtu në muajin gusht Aleanca Kombëtare e Këshilltarëve ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësuese "Përfshihu përfshirë qytetin tênd". Ne siguruam që qytetarët të janë aktivë e të përfshihen në çështjet e qeverisjes vendore. Në kuadër të kësaj fushate ne hartuam një pyetësor përfshirë mendimin e qytetarëve me profilin që duhet të ketë kandidati përfshirë këshilltar bashkiak. Deri më sot rrëth 1000 qytetarë kanë përcjellë mendimin e tyre përmes përgjigjeve të administruara nga kryesia e Aleanca Kombëtare të Këshilltarëve. Disa nga kriteret që mund të ndihmojnë në krijimin e një profili përfshirë këshilltarët janë:

1- Integriteti dhe morali intelektual. Oratoria dhe njohja mirë e politikave lokale dhe komëbtare.

2- Njohja e çështjeve lokale. Gadishmëria përfshirë mbrojtur territorin. Aftësia përfshirë ekuilibruar nevojat territoriale kundrejt nevojave kombëtare ose partiake. Jeton në zonën elektorale, vjen nga zona lokale.

3- Të jetë një dëgjues i mirë, i durueshëm i përgjegjshëm. Aftësia përfshirë ushtruar gjykim të shëndoshë kur përballet me pamjen konfliktuale. Aftësi komunikimi, gadishmëria përfshirë ndërrmarë veprime kur eshtë e përshtatshme. I ndërgjegjshëm, shqetësim të mirëfilltë përfshirë çështjet lokale, të jetë edhe i afroeshëm.

4- Aftësia për të komunikuar me zgjedhësit për çështje kombëtare, aftësia për të mbrojtur vendimet e marra, aftësia për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme.


5- Të ketë aftësi drejtuese, të jetë një lehtësues i mirë dhe motivues i mirë. Të jetë në gjëndje të bindë të tjerët. Të jetë mbrojtës i intubuar i interesave, të jetë në gjëndje të hyjë dhe të ndikojë tek ata që janë në pushtet. Motivimi për të ndërmarrë veprime për çështje të rëndësishme për zgjedhësit. Aftësia për të mobilizuar mbështetjen për një politikë të caktuar dhe aftësinë për të formuluar politika efektive. Të kuptojë nevojat dhe perspektivat e zgjedhësve. Aftësi për të komunikuar këto nevoja në mënyrë efektive dhe aftësi për ti bindur të tjerët. Të jetë një lojtar në ekipin e partisë, i aftë për të negociar në mënyrë efektive, në gjëndje të qëndrojë në këmbë por edhe të pranojë kompromisin. Të jetë mbështetës apo mbështetëse e parimeve demokratike. Rezistent ndaj korruptionit, person me integritet dhe standarte të larta morale. Prezantim i këtyre kriterieve shpresojmë të sjellë edhe njëherë në vëmendje dhe të rrisë vëmendjen e qytetarëve dhe aktorëve vendimarrës për një profil sa më të denjë të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Pika 17 e rendit të ditës

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kërkesa- ankesa të qytetarëve. Është një material që besoj se është shpérndarë. Drejtuar Këshillit Bashkiak Korçë nga z.Qerim Haxhiu në lidhje me vlerësimin e një figure atdhetare sipas kërkesës për emërtimin me emrin e tij të një rruge ose institucioni publik si psh shkollë e pa emërtuar në territorin e bashkisë Korçë. Pa u marrë në detaje se ky është një proces që nuk vendoset në moment, unë këtë material ja kaloj komisionit përkatës dhe këshillit të kulturës ta kenë në konsideratë që në emërtesat që dojenë të marrin në shqyrtim dhe këtë emër dhe vlerësimet që ata do të bëjnë ta kenë në konsideratë. Ka nga këhilltarët diçka për këtë çështje kush e ka parë materialin ? Nuk ka, ndonjë kërkesë, pyetje tjetër? Meqënëse s'ka diskutime e deklaroj mbledhjen e myllur.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

